

# **Shqiperia dhe OBT-ja: Veshtrim mbi Angazhimet**

Pregatitur per:  
**Qendren Shqiptare per Tregtine Nderkombetare**

**Engjell Skreli**  
Shkurt, 2004

## Hyrje

Veshtrimi mbi angazhimet e Shqiperise ne kuader te OBT-se eshte nje ushtrim kompleks, sic eshte kompleks edhe vete korpusi ligjor i ketij institucioni. Ne kete kuader, trajtimi duhet konsideruar si nje perpjekje modeste – dhe aspak shteruese – per te bere nje ‘inventarizim’ te angazhimeve shqiptare. Megjithese modest, trajtimi pretendon te hedhe nje veshtrim teresor mbi keto angazhime.

Ne veshtrimin e meposhtem teksti baze eshte strukturuar ne dy pjese:

- Struktura ligjore e OBT-se dhe
- Angazhimet shqiptare ne kuader te OBT-se

Pjesa e pare sherben si nje ‘template’ strukturues per trajtimin e mepastajm, perfshire tekstin baze dhe anekset. Pervese ka funksionin e fillit te ‘Ariadnes’, pjesa e pare ndihmon per te ruajtur nje veshtrim teresor gjate gjithe konsultimit te materialit. Ne kete kuptim, sugjerohet qe lexuesi t’i kthehet here pas here per t’i gjeur vendin cdo detaji.

Ne pjesen e dyte jane perfshire nje numer pergjithesimesh lidhur me angazhimet ne tre fushat baze (mallra, sherbime, pronesi intelektuale). Kjo pjese e analizes sherben per nje lexim te shpejte dhe diskutim ‘grosso modo’. Nje diskutim me i thelluar, me profesional e me pragmatik do kishte si kusht konsultimin e vazhdueshem te anekseve ku te adreson teksti baze. Ne kete kuptim, anekset duhen konsideruar si pjese integrale e domosdoshme e analizes.

Ne fund, ne vend te konkluzioneve, preferohet te behen disa sugjerime lidhur me disa ceshtje qe do te kerkonin vemendje te metejshme. Lista e ketyre sugjerimeve eshte e hapur ...

## **Paqsyra e Lendes**

---

<b>Hyrje .....</b>	<b>2</b>
<b>1. Struktura ligjore e OBT-se.....</b>	<b>4</b>
<b>2. Angazhimet shqiptare ne kuader te OBT-se.....</b>	<b>5</b>
2.1.Tregtia ne mallra .....	5
2.2.Tregtia ne sherbime.....	7
2.3. Pronesia intelektuale .....	8
2.4.Angazhimet per transparence.....	8
2.5.Marreveshjet plurilaterale .....	8
<b>3. Per vemendje te metejshme... ..</b>	<b>9</b>
<b>Anekse .....</b>	<b>10</b>

## 1. Struktura ligjore e OBT-se

Tekstet ligjore, ose marreveshjet e arritura ne kuader te OBT-se, mund te ndahen ne 6 grupe kryesore<sup>1</sup>:

- marreveshja ombrelle (Marreveshja qe themelon OBT-ne);
- marreveshje per secilen nga tre fushat e gjera te tregtise qe mbulon OBT-ja (mallrat, sherbimet dhe pronesia intelektuale);
- rregulla per zgjidhjen e mosmarreveshjeve; dhe
- rregulla per rishikimin e politikave tregtare te qeverive.

Marreveshjet per dy fushat me te gjera — mallrat dhe sherbimet — strukturohen sipas nje skeme triptiku. Ky triptik permban:

- parimet e pergjitheshme: Marreveshja e Pergjitheshme mbi Tregtine ne Mallra (GATT), Marreveshja e Pergjitheshme mbi Tregtine ne Sherbime (GATS) dhe Aspektet Tregtare te Drejtave te Pronesise Intelektuale;
- marreveshjet dhe anekset e lidhura (me GATT dhe GATS), dhe anekset qe merren me sektore ose ceshtje specifike;
- listat e angazhimeve te marra nga vendet per liberalizimin e tregjeve. Per GATT-in, angazhimet marrin formen e angazhimeve te detyrueshme, dhe kombinimeve te tarifave dhe kuotave per disa produkte bujqesore. Per GATS, angazhimet tregojne se sa akses u eshte dhene ofruesve te sherbimeve per sektore specifike. Kjo do te thote se vendet kane te drejte te devijojne nga parimi i MFN. Ne kete rast, vendet duhet te tregojne se ku ato nuk do te zbatojne parimin MFN.

Pjese e struktures se OBT-se jane edhe *institucionet e zgjidhjes se mosmarreveshjeve* dhe *rishikimi i politikave tregtare* qe i sherben rritje se transparences se sistemit.

Fillimisht, Uruguai Round u mor me me shume me parimet e pergjitheshme dhe parimet per sektoret specifike. Ne te njejten kohe, u zhvilluan edhe negociata per liberalizimin e tregjeve per produktet industriale. Mbasi i perpunuan parimet e mesiperme, mund te vazhdonin negociatat per liberalizimin e tregjeve bujqesore dhe sherbimeve.

### Struktura baze e OBT-se

Ombrella	Marreveshja qe themelon OBT		
	Mallrat	Sherbimet	Pronesia intelektuale
Parimet baze	GATT	GATS	TRIPS
Detaje shtese	Marreveshje dhe anekse te lidhura me GATT	Anekse sherbimesh	
Angazhimet per liberalizimin e tregjeve	Oferta e angazhimeve	Oferta e angazhimeve (me perjashtime nga parimi i MFN)	
Zgjidhja e mosmarreveshjeve	Zgjidhja e mosmarreveshjeve		
Transparenca	Rishikimi i politikave tregtare		

Struktura e mesiperme, mban parasysh vetem marreveshjet multilaterale, pra marrveshjet ku duhet te aderojne te gjithe antaret e OBT-se. Nderkaq, nje kuptim me i gjere i struktures se OBT se do te duhej te perfshinte edhe marreveshjet plurilaterale, qe jane marreveshje te hapura per t'u pranuar.

<sup>1</sup> Ne pasqyren qe vijon, grupet jane bolduar

## 2. Angazhimet shqiptare ne kuader te OBT-se

Angazhimet shqiptare ne kuader te OBT-se duhet te konsiderohen tri fusha kryesore:

- Tregtia ne mallra (GATT)
- Tregtia ne sherbime (GATS) , dhe
- Pronesia Intelektuale (TRIPS),

dhe te pakten dy dimensione:

- perqasjen e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e OBT-se,
- oferten konkrete shqiptare ne secilen nga fushat e mesiperme.

Nderkaq, nje veshtrim me i plote mbi angazhimet do te duhet te perfshinte edhe *angazhimet per transparence* dhe angazhimet lidhur me *marrveshjet plurilaterale*.

### 2.1. Tregtia ne mallra

#### 2.1.1. Perqasja e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e OBT-se

Me antaresimin ne OBT, Shqiperia eshte angazhuar te perqase legjislacionin e saj me ate te OBT-se. Dokumenti qe permban parimet baze te tregtise ne mallra eshte Marreveshja e Pergjithshme mbi Tregtine dhe Tarifat (GATT). Keto parime perfaqesohen nga kater rregulla baze dhe nje numer rregullash te tjera te pergjitheshme. Marreveshja e Pergjitheshme e Tregtise dhe Tarifave interpretohet dhe plotesohet, pra behet operacionale, permes nje sere marreveshjesh te tjera te lidhura me GATT<sup>2</sup>.

Cdo vend antar i OBT duhet te pershtase legjislacionin e vet sipas ketyre marreveshjeve. Premtimet zyrtare per sjelljen e legjislacionit te vendit ne linje me marreveshjet e OBT konvertohen ne angazhime konkrete te monitorueshme.

Angazhimet shqiptare per perqasjen e legjislacionit me ate te BE-se, mund te permbliidhen si me poshte<sup>3</sup>:

- Shqiperia angazhohet qe *te gjitha ligjet e rregullat, si dhe tarifat, pagesat e taksat ne tregtine e mallrave te jete konform marrveshjeve te OBT-se, qe ne momentin e antaresimit*. Zbatimi do te jete gjithashtu konform rregullave te OBT-se;
- Ne cdo rast, *para antaresimit, Shqiperia duhet te beje amendime* ne legjislacionin qe lidhet me (i) masat sanitare e fitosanitare, (ii) rregullat teknike ne tregti, (iii) procedurat e licencimit te importeve<sup>4</sup>, me qellim qe legjislacioni i saj te konsiderohet konform rregullave te OBT-se;
- Shqiperia angazhohet te zbatoje te gjitha marreveshjet e OBT-se, perfshire edhe ate te masave sanitare e fitosanitare e te rregullave teknike ne tregti, *pa ndonje periudhe tranzicioni*;
- Shqiperia angazhohet *te mos aplikoj masa antidumping, kunderbalancuese dhe sigurie pa plotesuar legjislacionin perkates* dhe pa e sjelle ate ne linje me OBT-ne;

<sup>2</sup> Shih Aneks 1: GATT: Parimet baze dhe anekse specifike

<sup>3</sup> Per me shume detaje lidhur me angazhimet konkrete, shih Aneks 2: Angazhimet shqiptare lidhur me regjimin e tregtise se jashtme

<sup>4</sup> Per me shume detaje, lidhur me SPS, TBT, Procedurat e Licencimit te Importeve, shih [www.wto.org](http://www.wto.org). WT/ACC/ALB/40/Rev.2: Ndryshime ne legjislacionin shqiptare per tu konformuar me marveshjet e OBT-se

- Ne pergjigje te interesimit te vendeve antare, Shqiperia angazhohet specifikisht ne ceshtje qe lidhen me *vleresimin doganor dhe rregullat e origjines*.

### 2.1.2. Oferta per tregun e mallrave

**Oferta ne tregun e mallrave** karakterizohet nga keto tipare:

- Sistem tarifer eshte i thjeshte dhe perfaqesohet vetem nga tarifa *ad valorem*. Sisteme alternative do te mund te permbanin tarifa fikse, specifike, ose te kombinuara, etj;
- Mbrojtja tarifore eshte e moderuar. Niveli maksimal i tarifave detyruese eshte 20%. Struktura fillestare e tarifave eshte si me poshte:

Tarifa	Numri i linjat tarifore, ne % ndaj totalit
20%	29
10%	37
0-5%	34

- Rreth 80% e tarifave detyruese kane te njejtin nivel me tarifate aktuale
- Logjika e reduktimit ne zero<sup>5</sup> te tarifave te produkteve lidhet – si rregull – me:
  - Marrveshje ose deklarata shumeplaleshe, ose me produkte te lidhura me to, te tilla si me Deklaraten Ministeriale mbi Tregtine ne Produktet e Teknologjise se Informacionit, i cili thote se tarifate per keto produkte duhet te behen zero mes 1997 dhe 2000 me nje hap konstant reduktimi, me detyrimet nga antaresimin ne Marrveshjen Plurilaterale te Aviacionit Civil,
  - Konkencione per produkte qe materializojne sa me pak vlere te shtuar, ne pergjigje te kerkeses per konkencione nga vende antare;
  - Reduktim i tarifave per lendet e para per te nxitur prodhimin vendas.

**Oferta bujqesore e mallrave** karakterizohet nga keto tipare:

- Mungesa e programeve aktive te mbeshtetjes permes subvencioneve<sup>6</sup>;
  - Vlere de minimis eshte 5%, ndersa masa agregate e mbeshtetjes (AMS) eshte zero;
  - Shpenzimet qe bien ne kategorine e „kutise jeshile”<sup>7</sup> jane modeste dhe perbehen nga shpenzime per kerkimin, trainimin, ektensionin, sherbimet e inspektimit dhe ato te infrastrukturave, pagesat per fatkeqesite natyrore, etj.;
- Mungesa e kuotave tarifore;
- Mungesa e tarifave preferenciale kryesisht per shkak te mungeses se Marrveshjeve te Tregtise se Lire ne momentin e antaresimit ne OBT, por edhe per shkak te politikave te tjera preferenciale;

<sup>5</sup> Per menyren e reduktimit sipas viteve te produkteve tarifa e te cilave shkon ne zero, shih: Albania: Staging Matrix, pjese integrale e Ofertes se mallrave. Ne fakt, edhe reduktimi ndjek kete rregull

<sup>6</sup> Per me shume detaje shih [www.wto.org](http://www.wto.org); WT/ACC/SPEC/ALB/4/Rev.4

<sup>7</sup> Shih Aneks 3: Kutia jeshile

- Mungesa e subvencioneve per eksportet, pra edhe mungesa e angazhimeve per reduktime te ketij tipi te ndaluar subvencionesh;
- Reduktim ne zero te tarifave, por edhe te reduktimit ne teresi, sipas dy logjikave:
  - Respektimit te detyrimeve te marrveshjeve multilaterale, psh rasti i iniciatives sektoriale te pijeve alkolike;
  - Konkencione ne pergjigje te kerkeses per konkencione nga vende antare;
  - Impotin e lendeve te para per stimulimin e prodhimit vendas.

## 2.2. Tregtia ne sherbime

### 2.2.1. Perqasja e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e OBT-se

Marreveshja e Pergjithshme mbi Tregtine ne Sherbime (GATS) permban parimet baze te tregtise ne sherbime, te tilla si parimi i kombit me te favorizuar *me perjashtime, konkencione ne tregje, akordim te statusit te trajtimit komberar, kerkesen per transparence*, per te permendur vetem disa. GATS interpretohet dhe plotesohet, pra behet operacionale, permes nje sere marreveshjesh te tjera te lidhura me te, te tilla si levizja e personale fizike, sherbimet financiare, telekomunikacioni, transporti ajror dhe transporti detar<sup>8</sup>.

Angazhimet e Shqiperise per perqasjen e legjislacionit ne fushen e sherbimeve, mund te konsiderohen ne dy nivele:

- pergatitjen e kuadrit ligjor per krijimin e inquiry points, si nje nga parimet baze te tregtise ne sherbime, dhe
- trajtimin e ndermarrjeve publike dhe ndermarrjeve me privilegje speciale e ekskluzivitetet ne perputhje me rregullat e OBT-se<sup>9</sup>.

### 2.2.2. Oferta per tregjet e sherbimeve

Oferta per tregjet e sherbimeve mbeshtetet ne parimet baze, dhe ndikohet ne menyre substanciale nga marreveshjet specifike.

Karakteristikat e ofertes shqiptare ne tregun e sherbimeve mund te permbledhen si me poshte<sup>10</sup>:

- Shqiperia ne parim ka akorduar *statusin e kombit me te favorizuar* per pothuaj te gjitha llojet e sherbimeve, me perjashtim te disa sherbimeve te transportit dhe audiovizuale, per te cilat ben trajtim preferencial. Trajtimi preferencial kushtezohet nga marreveshje bi- ose multi-laterale;
- Megjithese *aksesi ne tregje* nuk eshte detyrim, palet bejne konkencione. Ne rastin e Shqiperise, aksesi ne tregje mund te konsiderohet si rregull. Kufizimet lidhur me aksesin ne tregje kane ne origjine: (i) kufizimet ne levizjen e personave fizike, (ii) kufizime ne

<sup>8</sup> Per me shume detaje, shih Aneks 5: GATS: Parimet baze dhe Aneks per ceshtje specifike

<sup>9</sup> Shih Aneks 2: Angazhimet shqiptare lidhur me regjimin e tregtise se jashtme

<sup>10</sup> Per me shume detaje, shih Aneks: Aneks 6: Oferta per tregun e sherbimeve

eksportin e kapitaleve, (iii) kufizime ne tregjet e telekomunikacioneve dhe (iv) kufizime te tjera;

- Akordimi i statusit te *trajtimet kombetar*, mund te konsiderohet gjithshtu si nje rregull. Kufizimet ne trajtimin kombetar kane ne origjine (i) kufizimet ne tregun e tokes jo bujqesore, (ii) kufizime ne sherbimet spitalore e profesionale mjekesore, (iii) kufizime ne sherbimet ligjore, (iv) kufizime ne sherbimin e sigurimeve, (v) kufizime ne sherbimet e kinemase dhe teatrit.

### 2.3. Pronesia intelektuale

Ne momentin e antaresimit, Shqiperia konsiderohej se ishte ne perputhje me Marrveshjen mbi Pronesisne Intelektuale<sup>11</sup>.

Shqiperia angazhohet te zbatoje Marreveshjen mbi **Pronesine Intelektuale** pa ndonje periudhe tranzicioni.

### 2.4. Angazhimet per transparence

Nje nga gjashte bloqet legale te OBT-se eshte ai qe lidhet me detyrimin per te bere transparent masat, politikat dhe ligjet qe prekin tregtine e jashtme. Sipas ketij legjislacioni, kjo arrihet ne dy rruge: (i) qeverite duhet te informojne OBT-ne dhe vendet antare mbi masat, politikat ose ligjet specifike permes notifikimeve te rregullta, dhe (ii) OBT-se ndermerr rishikime te rregullta te politikave tregtare te vendeve antare, ose ato qe quhen riskikime te politikave tregtare.

Ne kontekstin e mesiperm, Shqiperia eshte angazhuar te beje notifikimet e kerkuara nga cdo marrveshje/dhe te gjiatha marrveshjet qe jane pjese e struktures ligjore te OBT-se.

### 2.5. Marreveshjet plurilaterale

Lidhur me marreveshjet plurilaterale, Shqiperia ka marre angazhimet e meposhtme:

- Te filloje negociatat per antersimin ne **Marreveshjen e Prokurimit Qeveritar**, me objektivin per t'u antaresuar ne fund te vitit 2000<sup>12</sup>;
- Te zbatoje **Marrveshjen mbi Tregtine ne Aviacion Civil** dhe do te jete gati ta nenshkruaje ate ne momentin e antaresimit. Importi i avioneve civile dhe pjeseve te tyre do te jete zero ne momentin e antaresimit

<sup>11</sup> Per me shume detaje mbi kuadrin ligjor dhe perpjekjet e Shqiperise per tu konformuar me Marreveshjen e Pronesisne Intelektuale, shih [www.wto.org](http://www.wto.org), WT/ACC/ALB/25: Information on the economy and foreign trade regime: Compliance with TRIPS agreements

<sup>12</sup> Per me shume detaje mbi perputhjen e ligjit shqiptar te Prokurimit Publik me marrveshjen respective te OBT-se, shih [www.wto.org](http://www.wto.org), WT/ACC/ALB/42: Memorandum on Compliance with the Agreement on Government Procurement



### 3. Per vemendje te metejshme...

Veshtrimi mbi angazhimet e Shqiperise ne OBT ka synuar te jape nje permbledhje sa me teresore te angazhimeve. Nderkaq, nje numer ceshtjesh dhe subjektesh kerkojne thellim dhe ndjekje te metejshme :

– **Thellimi ne tekstet ligjore te marreveshjeve te OBT-se**

Ne tekstin baze, por sidomos ne anekse, jepen shume referenca ligjore qe kane te bejne me marreveshjet e OBT-se. Psh, nje angazhimet eshte se Shqiperia angazhohet te zbatoje Marreveshjen mbi Pronesine Intelektuale pa ndonje periudhe tranzicioni. Respektimi i ketij angazhimi do te kerkonet ne radhe te pare te kuptohet mire se ceshte Marreveshja e Pronesise Intelektuale, cili eshte legjislacioni shqiptar i lidhur me kete ceshtje, si do te sigurohet qe ky legjislacion te jete konform Marrveshjes ne vazhdimesi e ceshtje te tjera si keto;

– **Ndjekja e realizimit te angazhimeve te marra, sidomos ne perqasjen e legjislacionit te vendit me ate te OBT-se**

Nga trajtimi i bere me siper Paragrafi 2, del se Shqiperia ka marre angazhime ne dy nivele: (i) respektimin e te gjitha marrveshjeve multilaterale qe perbejne OBT-ne, dhe (ii) koncensione konkrete ne tregjet e mallrave dhe sherbimeve. Nese ka mjaft vemendje per respektimin e angazhimeve te koncensioneve ne tregje, sidomos ne tregjet e mallrave, vemendja per tregjet e sherbimeve, e sidomos per perqasjen e legjislacionit dhe ngritjen e institucioneve perkatese eshte eshte e pamjaftueshme ;

– **Sigurimi i zbatimit te marrveshjeve te OBT-se**

Ne shume raste, Shqiperia ka marre angazhim qe jo vetem te pershtase legjislacionin me ate te OBT-se per edhe ta zbatoje ne menyre konsistente. Zbatimi i legjislacionit ne menyre konsistente eshte problematike ne nje sere fushash, te tilla si vleresimi doganor, rregullat teknike, masat sanitare e fitosanitare, pronesine intelektuale, etj. Psh, nje nga kerkesat e themelore te Marrveshjes Sanitare e Fitosanitare e Marrveshjes mbi Rregullat Teknike eshte sigurimi i transparences ne nivelin e institucioneve qe lidhen me keto politika, dhe ne nje nivel koordinues, nje inquiry point e vetme. Legjislacioni ekziston por nuk zbatohet !

– **Kompletimi i legjislacionit lidhur me masat per nje tregti te drejte**

Shqiperia ka marre angazhimin te mos perdore masat antidumping, kunderbalancuese dhe masa sigurie pa plotesuar legjislacionin kombetar dhe pa e sjelle ate ne linje me marreveshjet e OBT-se. Ne kushtet kur legjislacioni ne keto fusha eshte teper i manget (kuadri ligjor mbi antidumpingun eshte i manget, kuadri ligjor mbi masat kunderbalancuese dhe ato te sigurise nuk egziston fare), Shqiperia qe ka pranuar te respektojte rregullat e lojes te tregtise nderkombetare eshte ne disavantazh ne raport me vende te tjera, qe po i perdorin me sukses keto masa. Le te kujtojme se liberalizimi qe te jete efektiv duhet te jete i drejte;

– **E hapur per te shtuar ceshtje te tjera ...**

## **Anekse**

## Aneks 1

### GATT: Parimet baze dhe Marrevshje dhe Anekse specifike

---

#### Parimet baze te GATT

Parimet baze qe rregullojne tragtime ne mallra permbahen ne Marrevshjen e Pergjitheshme te Tregtise dhe Tarifave (Tregtia ne mallra: GATT). Me antaresimin ne OBT, Shqiperia eshte angazhuar te respektojte parimet baze te GATT. Keto parime perfaqesohen nga kater rregulla baze dhe nje numer rregullash te tjera te pergjitheshme.

#### Kater rregullat baze te GATT

---

- Tarifizimi;
- Fiksimi i tarifave;
- Parimi i Kombit me te Favirizuar (MFN), dhe
- Parimi i Trajtimit Kombetar (NT).

#### Rregulla te tjera te pergjitheshme te GATT

---

- Vleresimi doganor;
- Inspektimi para ngarkeses;
- Rregullat teknike dhe masat sanitare dhe fitosanitare;
- Rregullat per eksportet;
- Rregulla mbi subvencionet;
- Rregulla mbi licensimin e importeve;
- Rregulla mbi masa te autorizuar per mbrojtjen e industrive;
- Rregulla masa te lidhura me investimet qe prekin tregtine.

#### Marrevshje dhe anekse per produkte ose ceshtje specifike

Marrevshja e Pergjitheshme e Tregtise dhe Tarifave interpretohet dhe plotesohet, pra behet operacionale, permes nje sere marrevshjesh te tjera.

Marrvshjet specifike jane keto:

- Marrvshja e Vleresimit Doganor;
- Marrvshja e Inspektimit para Ngarkeses;
- Marrvshja e Barrierave Teknike ne Tregti;
- Marrvshja e Masave Sanitare e Fitosanitare;
- Marrvshja e Procedurat te Licencimit te Importeve;
- Marrvshja e Masave te Sigurise;
- Marrvshja mbi Subvencionet dhe Masat Kunderbalancuese;
- Marrvshja e Antidumping dhe Masave Kunderbancuese;
- Marrvshja mbi Politikat e Investimeve qe prekin Tregtine (TRIMS);
- Tekstilet dhe Veshjet;
- Marrvshja e Bujqesse;
- Marrvshja mbi Rregullat e Origjines.

**Aneks 2**  
**Angazhimet shqiptare lidhur me regjimin e tregtise se jashtme**

<b>Angazhimi – me anetaresimin ne OBT:</b>	<b>Referenca<sup>13</sup></b>
Shqiperia do te respektoje rregullat e OBT lidhur me <b>kontrollin e cmimeve</b> . Ne momentin e antaresimit, Shqiperia kontrollon cmimet per medikamentet, energjine, ujin dhe transportin <sup>14</sup> .	Neni III.9 i GATT <sup>15</sup>
Shqiperia do te konformoje me detyrimet e OBT te gjitha <b>gjitha ligjet dhe rregullat, si dhe tarifate pagesat e taksat</b> , lidhur me tregtine ne mallra. Zbatimi do te jete gjithashtu konform rregullave te OBT-se	Neni VIII:1, XI:1 dhe III:2, 4 i GATT
Cod <b>tarife e takse ndaj importeve</b> , pervec tarifave doganore e tarifave e pagesave normale per sherbimet e kryera, do te jete konform rregullave te OBT-se. S qiperia nuk do te vendose <u>pagesa</u> te tjera ne oferten e mallrave, pra angazhohet ti mbaje ato zero.	Neni II:1(b) i GATT
Shqiperia do te zbatoje <b>taksat e akcizes</b> ne konformitet te plote me rregullat e OBT-se	Neni III i GATT
Shqiperia do te zbatoje rregullat mbi <b>TVSH</b> ne konformitet te plote me rregullat e OBT-se	Neni III i GATT
Shqiperia do te konformohet me rregullat e OBT-se lidhur me <b>kufizimet sasiore mbi eksportet dhe masat e tjera jo tarifore</b> , te tilla si licencat, kuotat, ndalimet, dhe kufizimet e tjera qe kane efekt ekuivalent. Per tu konformuar, Shqiperia duhet te amendoje nje sere ligjesh e aktesh nenligjore <sup>16</sup> . Masat e lidhura me bilancin e pagesave do te jene gjithashtu konform rregullave te OBT-se	Neni 12 i GATT; SPS (M); Kuptimi i Rregullave mbi Bilancin e Pagesave te GATT
Shqiperia do te konfirmoje se ka <b>publikuar</b> udhezimet qe spjegojne se <b>kur 'autoritetet doganore do te mund te kerkojne garanci'</b> .	Vleresimi Doganor (M)
Shqiperia do te konformohet me rregullat e <b>vleresimit doganor</b> . Ne cdo rast, rregullat qe jane pjese e marreveshjeve nderkombetare do te jene superiore ndaj legjislacionit vendas mbas antaresimit ne OBT	Neni VII i GATT, Shenim Interpretues i Nenit VII, Vleresimi i Media Carrier
<b>Vlera e transaksionit e filmave kinematografike</b> nuk do te perfshijne te drejtat e autorit dhe tarifate licencave. Amendimi i ligjit te Kodit Doganor <sup>17</sup> dhe kuadrit nenligjor perkates eshte i nevojshem per te qene konform rregullave e vleresimit Doganor	Vleresimi Doganor (M)
Shqiperia do te konformohet plotesisht me rregullat e OBT-se mbi <b>orgjinen e mallrave</b> . Ne cdo rast, nga momenti i ntaresimit, doganat do te jene te detyruara te japin informacion mbi vlerresimin e origjines, nese kjo kerkohet nga eksportuesi, importuesi, ose persona te tjere te justifikuar	Rregullat e Origjines (M)
Shqiperia do te respektoje rregullat e OBT-se lidhur me <b>inspektimin para ngarkeses</b>	Inspektimi para Ngarkeses

<sup>13</sup> Ka nevojte te sqarohet ne menyre eksplicite kuptimi ekonomik dhe juriduk i ketyre angazhimeve

<sup>14</sup> [www.wto.org](http://www.wto.org), WT/ACC/ALB/25

<sup>15</sup> Lexo GATT 1994

<sup>16</sup> Aneks 4: Angazhimet Shqiptare per perqasjen e legjislacionit

<sup>17</sup> Aneks 4: Angazhimet Shqiptare per perqasjen e legjislacionit

	(M)
Shqiperia angazhohet te mos aplikoj masa <b>antidumping ose kunderbalancuese</b> para se te kete hartuar kuadrin perkates ligjor konform rregullave te OBT-se. Pas kompletimit te kuadrin ligjor, Shqiperia angazhohet qe edhe zbatimi te jete konform rregullave te OBT-se	Neni VI i GATT, Zbatimi i Neni VI (M), Subvencionet dhe Masat Kunderbalancuese (M)
Shqiperia angazhohet te mos aplikoj masa <b>sigurie</b> para se te kete hartuar kuadrin perkates ligjor konform rregullave te OBT-se. Pas kompletimit te kuadrin ligjor, Shqiperia angazhohet qe edhe zbatimi te jete konform rregullave te OBT-se	Neni XIX i GATT, Marrveshja mbi Masat e Sigurise
Shqiperia angazhohet qe <b>kufizimet e eksporteve</b> do te behen konform rregullave te OBT. Shqiperia ka hequr ndalimin mbi produktet e mbetura te eksportev <sup>18</sup>	Nenet XI, XVII, XX dhe XXI te GATT
Shqiperia nuk do te mbaje dhe nuk do te riaplikoj <b>subvencione te ndaluara eksportesh</b> , ne kuptimin e Neni 3 te Marrveshjes mbi Subvencionet dhe Masat Kunderbalancuese	Subvencionet dhe Masat Kunderbalancuese (M)
<b>Programet qeveritare mbi subvencionet</b> do te administrohen nga Marrveshja mbi Subvencionet dhe Masat Kunderbalancuese dhe do te notifikohet cdo informacion i notifikueshem	Subvencionet dhe Masat Kunderbalancuese (M)
Shqiperia angazhohet te zbatoje Marrveshjen mbi <b>Rregullat Teknike</b> pa ndonje periudhe tranzicioni <sup>19</sup>	Rregullat Teknike te Tregtise (M)
Shqiperia angazhohet te zbatoje Marrveshjen mbi <b>Masat Sanitare dhe Fitosanitare</b> pa ndonjeperiudhe tranzicioni <sup>20</sup>	Masat Sanitare dhe Fitosanitare (M)
Shqiperia angazhohet te zbatoje Marrveshjen mbi <b>Masat Investuese te Lidhura me Tregtine</b> pa ndonjeperiudhe tranzicioni	Masat Investuese te Lidhura me Tregtine (TRIMS)
<b>Ndermarrjet publike dhe ndermarrjet me privilegje speciale ose ekskluzivite</b> do te trajtohen ne perputhje me rregullat e OBT-se	Neni XVII i GATT dhe Kuptimi i Neni VIII te GATS
Shqiperia angazhohet te respektoj rregullat e OBT-se per sa i perket menaxhimit te zonave te lira	

<sup>18</sup> [www.wto.org](http://www.wto.org), WT/ACC/ALB/34/Rev.1

<sup>19</sup> Aneks 4: Angazhimet Shqiptare per perqasjen e legjislacionit

<sup>20</sup> Aneks 4: Angazhimet Shqiptare per perqasjen e legjislacionit

**Aneks 3**  
**Kutia Jeshile**

---

**Lista e subvencioneve qeveritare per prodhuesit qe perjashtohen nga angazhimet per reduktim**

**Marrveshja e Bujqesise, Aneksi 2**

Subvencionet e meposhtme perjashtohen nga angazhimet e reduktimit, nese plotesohen kushtet specifike te permendura ne marrveshje:

- Shpenzimet qeveritare per kerkimin bujqesor, kontrollin e demtuesve, inspektimin dhe standartizimin e produkteve specifike, sherbimet e marketingut dhe promovimit;
- Pjesemarrja qeveritare ne programet e garantimit te te ardhurave, dhe ne programet e te ardhurave minimale;
- Pagesat per fatkeqesite natyrore;
- Asistenca per pershatjen strukturore, permes:
  - Programet e pershatjes (konvertimit) se prodhuesve qe synojne te lehtesojne pershatjen e personale te angazhuar ne produkte bujqesore te marketueshme;
  - Programet e pershatjes qe synojne te largojne token dhe burime te tjera, perfshire edhe blegtorine, nga prodhimi bujqesor;
  - Ndihamat financiare qe synojne te asistojne ristrukturimin financiar dhe fizik te operacione te prodhuesve;
- Pagesat per programet e mbrojtjes se mjedisit;
- Pagesat per programet e asistences rajonale

**Aneks 4**  
**Angazhimet Shqiptare per perqasjen e legjislacionit<sup>21</sup>**

<b>Marreveshja, ose aneksi</b>	<b>Angazhimi</b>	<b>Permbajtja</b>	<b>Afati</b>	<b>Statusi</b>
1. Vleresimi Doganor (M)				
2. Inspektimi para Ngarkeses (M)				
3. Barrierat Teknike ne Tregti				
4. Masat Sanitare e Fitosanitare (M)				
5. Procedurat e Licencimit te Importeve (M)				
6. Masat e Sigurise (M)				
7. Subvencionet dhe Masat Kunderbalancuese (M)				
8. Antidumping (M)				
9. Politikat e Investimeve qe prekin Tregtine (M)				
10. Tekstilet dhe Veshjet (M)				
11. Bujqesia (M)				
12. Rregullat e Origjines (M)				

<sup>21</sup>[www.wto.org](http://www.wto.org), WT/ACC/ALB/40/Rev.2; Changes in Albanian Legislation for Complying with WTO agreements

## Aneks 5

### GATS: Parimet baze dhe Anekse per ceshtje specifike

#### Parimet baze

##### Rregulla baze per GATS

- Te gjitha llojet e sherbimeve mbulohen nga GATS
- Parimi i MFN eshte i vlefshem per te gjitha llojet e sherbimeve, me perjashtim te perjashtimeve eksplicite
- Hapja e tregjeve Trajtimi Kombetar nuk jane detyrime te pergjitheshme, por vendet marrin angazhime
  - \* Angazhimet individuale te cdo vendi negociohen dhe pastaj jane te detyrueshme (bound)
  - \* Liberalizim progresiv permes negociatash
  - \* Parimi i NT aplikohet ne fushat ku jane marre angazhime
- Transparenca ne legjislacion eshte e kerkuar: inquiry points
- Legjislacioni vendas (ne kuptimin e gjere) duhet te jete objektiv dhe i aresyeshem
- Pagesat nderkombetare jane normalisht te pakufizuara

#### Anekse per ceshtje specifike

Marreveshja e GATS ka identifikuar edhe peshe fusha specifike – qe jane organizuar ne pese anekset e sherbimeve - per te cilat liberalizimi i tregut duhet te behet me kujdes. Keto fusha jane levizja e personave fizike, sherbimet financiare, telekomunikacioni, transporti ajror dhe transporti detar.

##### Anekset e sherbimeve

###### – Levizja e personave fizike

Aneksi i lejon vendet te negociojne angazhime specifike mbi levizjen e personave fizike qe ofrojne sherbime. Nderkaq, marreveshja nuk aplikohet per masat qe lidhen me punesimin, shtetesine, qendrimin ose punesimin permanent.

###### – Sherbimet financiare

Aneksi mbi sherbimet financiare (pergjithesisht bankat dhe sigurimet) u njej paleve te drejten te marrin masa kujdesi te tilla si mbrojtjen e investoitoreve, depozituesve te parave, si dhe sigurimin e stabilitetit te sistemit financiar.

###### – Telekomunikacioni

Aneksi lidhet me telekomunikacionin publik. Kushtet qe lidhen me perdorimin e rrjeteve te telekomunikacionit public duhet te jene te tilla qe ofruerit e huaj te sherbimit te mund ta kene kete te drejte vetem nese ata lejohen ta bejne kete permes nje angazhimi specific. Nderkaq, kufizimet nuk duhet te jene me te medha se sa eshte e nevojshme per te mbrojtur pergjegjesine publike te operatorit lidhur me sherbimin public dhe integritetin teknik te rrjetit

###### – Transporti ajror

Aneksi njej vec te tjerash te drejten e trajtimit preferencial, pra devijimin nga parimi i MFN

###### – Transporti detar

Aneksi njej te drejten e trajtimit preferencial, pra devijimin nga parimi i MFN. Nderkaq, aneksi njej edhe obligimin e sherbimeve te detyrueshme ne porte

Ne fakt, jane keto pese fusha qe – ne masen me te madhe - i japin forme nagazhimeve specifike shqiptare



## Aneks 6

### Oferta per tregun e sherbimeve

---

#### Parimi i Kombit me te Favorizuar (MFN)

Ne parim, Shqiperia zbaton parimin MFN, pra parimin e trajtimit jodiskriminues, me te gjithë vendet antare te OBT-se, per pothuaj gjithë gamen e sherbimeve. Bejne perjashtim nga parimi MFN vetem dy grupe sherbimesh<sup>22</sup>, per te cilat behet trajtim preferencial.

- Sherbimet e transportit
  - Rrugor te pasagjereve dhe ngarkesave;
  - Ajror, te lidhura me marketingun, shitjen e rezervimin kompjuterik;
- Sherbimet audio-vizuale
  - Prodhimi, shperndarja dhe transmetimi i veprave audio-vizive
  - Prodhimi dhe shperndarja e emisioneve televizive dhe veprave kinematografike

Si rregull, nje trajtim i tille preferencial, ose njohja e trajtimit kombetar per disa partnere tregtare dhe jo per te tjeret, lidhet me promovimin e vlerave kulturore (rasti i pergjitheshem: vlerave europiane). Arritja e objektivave liguistike eshte nje motivimi per trajtimin preferencial. Qe te perfitohet nga trajtimi preferencial, perkatesia ne te njejtat institucione, ose marreveshjet bilaterale jane te domosdoshme.

#### Hapja e tregjeve te sherbimeve dhe Trajtimi Kombetar (NT)

Ne baze te marrveshjes se GATS, koncensionet ne tregje dhe trajtimi kombetar nuk jane detyrime te pergjitheshme. Por, pritet qe palet te marrin angazhime per te hapur *gradualisht* tregjet dhe per te akorduar *gradualisht* trajtim kombetar ofruesve te sherbimeve ne origjine nga vendet antare te OBT-se.

#### Spjegime per oferten e sherbimeve

---

Kufizimet jane:

- H) Horizontale, qe do te kufizime me karakter te pergjitheshem dhe
- S) Specifike, qe prekin kategori specifike sherbimesh Menytrat e ofrimit te sherbimeve jane:

Menytrat e ofrimit te sherbimeve jane:

- |                                     |   |
|-------------------------------------|---|
| 1) Oferte permes kalimit te kufirit | Shembull: Ndertimi i rruges Librazh-Qukes nga firma maqedone                      |
| 2) Konsum jashte shtetit            | Shembull: Depozitimi i parave te nje firme shqiptare ne nje banke ne Zvicer       |
| 3) Prezence tragtare                | Shembull: Sherbimi i telefonise mobile nga VODAPHONE                              |
| 4) Prezence personash fizike.       | Shembull: I punesuari i nje firme te huaj sherbimesh te paregjistruar ne Shqiperi |

Megjithese koncensionet ne tregje dhe trajtimi kombetar nuk jane detyrime te pergjitheshme, nisur nga fakti qe rastet e koncensioneve ne tregje dhe ato te akordimit te trajtimit kombetar per Shqiperine jane rast i zakonshem, per arsye praktike, ne kemi konsideruar vetem rastet e

<sup>22</sup> Shih: [www.wto.org](http://www.wto.org), WT/ACC/ALB/51/Add.2, Schedule GATS-Albania

kufizimeve. Kjo do të thote se tregjet e shërbimeve konsiderohen të hapura, me përjashtim të kufizimeve eksplicite, dhe se trajtimi kombëtar është automatik, me përjashtim të kufizimeve eksplicite. Në parim, e anasjellta është e vertete.

### **Kufizime lidhur me hapjen e tregjeve të shërbimeve**

Kufizimet lidhur me aksesin në tregje, mund të ndahen në katër grupe kryesore<sup>23</sup>: (i) kufizime në levizjen e personave fizike, (ii) kufizime në levizjen e kapitaleve dhe në shërbimet financiare, (iii) kufizime në shërbimet e telekomunikacioneve, dhe (iv) kufizime të tjera.

#### – Kufizime në levizjen e personave fizike

Keto kufizime janë të natyrës horizontale (H), dhe si të tilla, ato prekin të gjitha kategoritë specifike të shërbimeve, që lidhen me tipin 4)<sup>24</sup> të ofrimit të shërbimeve. Formulimi në këto rast, duhet kuptuar në këto mënyra: Shqipëria ka kufizime lidhur me levizjen e personave fizike. Nderkaq, ajo ka bërë keto kondicionime: lejon qëndrimin në Shqipëri (i) deri 5 vjetë për personelin e lartë menaxherial; (ii) 6 muaj në çdo 12 muaj, për të punësuarit dhe shitesit e shërbimeve, dhe (iii) 3 muaj në çdo 12 muaj, për persona të mandatuar për të ngritur një firmë në Shqipëri.

#### – Kufizime në levizjen e kapitaleve dhe në shërbimet financiare

##### \* Kufizime në levizjen e kapitaleve

Banka e Shqipërisë ka të drejtën e kontrollit mbi eksportin e kapitaleve deri në vitin 2010. Ky kufizim është i natyrës H) dhe prek disa nga kategoritë e shërbimeve specifike të sektorit bankar, të tipit 2): konsum jashtë shtetit. P.sh., depozitimi i parave të një firme shqiptare në një bankë në Zvicër nuk është i lejuar automatikisht.

Shtetasit shqiptarë dhe ata të huaj janë të detyruar të marrin autorizim me shkrim në rastin e eksportit të kapitalit, nëse ky i fundit nuk bie në një nga kategoritë e mëposhtme: (i) kapitali i eksportuar është i barabartë me kapitalin e importuar plus fitimet, për shtetasit e huaj, dhe (ii) kapitali i eksportuar është i barabartë me kapitalin në pronësi të shtetit shqiptar, nëse ky i fundit largohet përfundimisht nga vendi.

##### \* Kufizime në shërbimet financiare

Për shkak të kufizimeve në levizjen e kapitalit, Shqipëria ka vendosur – jo në mënyra direkte, por si pasoje e këtyre kufizimeve – kufizime të rëndësishme për një numër shërbimesh financiare të tipit pranë depozitash, lizing financiar, shërbime të transfertave të parave, shërbime të garancive, etj. Në parim, keto kufizime janë të tipit 1): Oferte përmes kalimit të kufirit, përveçse të tipit 2: konsum jashtë shtetit, sic është përmendur më lart.

##### Kufizime në tregun e sigurimeve (?)

Në nivelin e shërbimeve financiare, kufizime jo të tepruara ekzistojnë edhe për sa i përket disa funksioneve që tani për tani janë monopol i Bankës së Shqipërisë, të tilla si: shërbimet e settlement and clearing.

<sup>23</sup> Shih: [www.wto.org](http://www.wto.org), WT/ACC/ALB/51/Add.2, Schedule GATS-Albania

<sup>24</sup> Shih: Spjegime për ofertën e shërbimeve, në këto aneks

- Kufizime ne sherbimet e telekomunikacioneve  
Kompania shqiptare e telefonies fikse, Albtelecom, ka ekskluzivitet ne kete treg, deri ne 1 janar 2003<sup>25</sup>. Ky kufizim ne tregun e telefonise fikse, reflektohet ne nje numer kufizimesh te tjera te tipit 1): oferte permes kalimit te kufirit ne zonat urbane, psh, Francetelecom e ka te pamundur organizoje sherbimin e telefonise publike ne Shqiperi, dhe te tipit 3) prezence tregtare, psh, ajo nuk eshte e lejuar te hyje ne Shqiperi deri ne vitin 2003.
- Kufizime te tjera  
Pervec kufizimeve te mesiperme, te organizuara sipas anekseve te sherbimeve, nga skeduli i angazhimeve mund te dallohen disa kufizime te tjera te rendesishme:
  - \* Kufizime ne sherbimet ligjore  
Sherbimet e avokatise dhe noterise ne Shqiperi mund te kryhen vetem nga juriste me shtetesi shqiptare. Kjo reflektohet ne kufizime te tipit 1), 3), dhe 4)
  - \* Kufizime ne sherbimet mjeksore dhe te tjera sherbime qe lidhen me sigurine e jetes  
Shqiperia nuk eshte e angazhuar te pranoje ne menyre automatike sherbimet mjekesore te klinikave te huaja. Personeli i sherbimeve mjeksore duhet te licensohet ne Shqiperi. Ne keto kushte, kufizimi reflektohet si kufizim i tipi 1). E njejta gje mund te thuhet edhe per sherbime te tjera qe lidhen me sigurine e jetes.
  - \* Kufizime ne sherbimet e argetimit, kulturore dhe sportive  
Kufizimet prekin sherbimet e kinemase dhe teatrit, tipi 1): oferte permes kufirit, si dhe arkivimit, tipi 1):oferte permes kufirit dhe 2): konsum jashte shtetit

### **Kufizime lidhur me trajtimin kombetar**

Kufizimet ne trajtimin kombetar, mund te ndahen ne 6 grupe: (i) kufizime ne tregun e tokes jo bujqesore, (ii) kufizime ne sherbimet spitalore e mjeksore profesionale, (iii) kufizime ne sherbimet ligjore, (iv) kufizime ne sherbimin e sigurimeve, dhe (v) kufizime ne sherbimet e kinemase dhe teatrit

- Kufizime ne tregun e tokes jo bujqesore  
Personat fizike ose juridike te huaj qe ofrojne, ose kane ndermend te ofrojne sherbime, ne Shqiperi kane te drejte te marrin me qera, ose te blejne toke jo bujqesore<sup>26</sup>. Blerja e tokes jo-bujqesore nga te huajt eshte e mundur vetem nese vlere e investimit eshte tri here me e madhe se vlere e tokes jo bujqesore.
- Kufizime ne sherbimet spitalore e profesionale mjeksore  
Kufizimet ne kete kategori sherbimesh jane te tipit 3): prezence tregtare dje 1):oferte permes kufirit. Kufizimi i tipit 3) duhet interpretuar ne kete menyre: kompanite gezojne trajtim kombetar, por licensimi duhet bere ne kooperim me nje profesionist shqiptar. Kufizimi 1) duhet interpretuar qe Shqiperia ka te drejten e diskrimimit mes presonelit mjeksor shqiptar dhe te huaj.

<sup>25</sup> Ky ekskluzivitet eshte shtyre deri me 1 janar 2005

<sup>26</sup> Shitja e tokes bujqesore te huajve eshte e ndaluar

- Kufizime ne sherbimet ligjore  
Sic eshte permendur edhe me pare, vetem shtetasit shqiptare kane te drejten per te ushtruar profesionin e avokatit dhe noterit, ne kuptimin e njohjes nga sistemi shqiptar i drejtesise
- Kufizime ne sherbimin e sigurimeve  
Kufizimi ne sherbimin e sigurimeve eshte pergjithsisht i tipit 3): prezence tregtare, por edhe i tipit 1) dhe 2).  
Kufizimi i tipit 3) duhet te interpretohet ne kete menyre: i vetmi diskriminim mes kompanive te huaja dhe atyre shqiptare lidhet me eksperiencen. Kompanite e huaja lejohet te vendosen ne Shqiperi me kushtin qe ato te kene te pakten 5 vjete aktivitet ne vendin e origjines. Mbas kesaj, trajtimi eshte i barabarte.  
Kufizimi i tipit 2): konsume jashte shtetit, do te thote se sigurimi i bere jashte shtetit eshte i vlefshem (?) per Shqiperine vetem pas 1 janarit 2003
- Kufizime ne sherbimet e kinemase dhe teatrit  
Kufizimi ne kete rast merr formen e tipit 1) dhe 3). Kufizimi i tipit 1) eshte konsistent me mosnjohjen e ofrimit ne Shqiperi te sherbimit te kinemase dhe teatrit nga kompani te huaja. Kufizimi i tipit 3) lidhet me mosperfitimin e subvencioneve nga kompanite e huaja te vendosura ne Shqiperi.

### **Angazhime shtese**

Ne skedulim e sherbimeve, pala shqiptare ka marre edhe keto angazhime shtese:

- Ne sherbimet e telekomunikacioneve  
Shqiperia do te marre pjese active ne raundet e ardhshme te negociatave me objektivin e thellimit te angazhimeve te saj ne sherbimet e telekomunikacioneve. Me tej, Shqiperia eshte angazhuar te publikoje rregullat dhe politiken rregullatore lidhur me konkurrencen ne fushen e telekomunikacioneve baze.
- Ne sherbimet financiare  
Shqiperia do te hape gradualisht tregun per kompanite e huaja mbi bazen e parimit te trajtimit kombetar, me kushtin qe (i) te jete pergatitur legjislacioni regulator lidhur me masat e kujdesit, ose (ii) ne rast se sherbime te tilla jane cfaqur ne treg permes privatizimit
- Sherbimet portuale  
Shqiperia angazhohet te veje ne dispozicion te kompanive te huaja nje sere sherbimesh portuale mbi baze jo diskriminuese

## Referencat

---

1. Legal texts: WTO Agreements, <http://www.wto.org>
2. [www.wto.org](http://www.wto.org), Understanding the WTO: The agreements: Overview: a navigational guide
3. UNCTAD/WTO, 1996, Business Guide to the Uruguay Round
4. [www.wto.org](http://www.wto.org), WT/ACC/ALB/51: Report on the Working Parties;
  - a. WT/ACC/ALB/31/Rev.2: **SPS** Memorandum
  - b. WT/ACC/ALB/32/Rev.3: **TBT** Memorandum
  - c. Memorandum on Restrictions and Prohibitions for **Importable products**
5. [www.wto.org](http://www.wto.org), WT/ACC/ALB/51/Add.1, **Goods Schedule**;
6. [www.wto.org](http://www.wto.org), WT/ACC/ALB/51/Add.2, **Services Schedule**;
7. [www.wto.org](http://www.wto.org), WT/ACC/SPEC/ALB/4/Rev.4; **Agricultural Schedule**
8. [www.wto.org](http://www.wto.org), WT/ACC/ALB/34/Rev.1; **Exportable products**
9. [www.wto.org](http://www.wto.org), WT/ACC/ALB/40/Rev.2; Changes in Albanian Legislation for Complying with WTO agreements;
10. [www.wto.org](http://www.wto.org), WT/ACC/ALB/42: Memorandum on Compliance with the Agreement on **Government Procurement**
11. [www.wto.org](http://www.wto.org), WT/ACC/ALB/25: Information on the economy and foreign trade regime
  - a. Compliance with **TRIPS** agreements
12. Ministry of Economy, 2003, Annual Report of the Ministry of Economy 2003